



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. Nr. 154/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Goran Milenkovic - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Office Printy” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me fasiklla te kartonit te fort me spag (litar konop) formati B4”**, me numër të prokurimit: PSH250/17/003/136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Prokurorial i Kosovës**, më: 09.06.2017, mori këtë :

V E N D I M

- I. **VËRTETOHET**, vendimi i **AK- Këshilli Prokurorial i Kosovës**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me fasiklla te kartonit të fort me spag (litar konop) formati B4”**, me numër të prokurimit: PSH250/17/003/136 dhe njëkohësisht autorizohet Autoriteti kontraktues që të vazhdoj me tutje me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **REFUZOHET**, si e pa bazuar ankesa e OE “Office Printy” - Prishtinë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **“Furnizim me fasiklla të kartonit të fort me spag (litar konop) formati B4”**, me numër të prokurimit: PSH250/17/003/136.

III. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues “Office Printy” - Prishtinë janë të paqëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, i behet konfiskimi i sigurimit të ankesës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt:27.03.2017, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt:04.05.2017, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë gjashtë operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:17.05.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Grafo Loni” – Prishtinë.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik “Office Printy”, është bërë konform nenit 108/A të LPP-se. Vendimi në lidhje me kërkesën për rishqyrtim ku është marr brenda afatit të paraparë me ligj.

Operatori ekonomik “Office Printy” - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 25.05.2017, me nr. të protokollit, 154/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE “Grafo Loni” - Prishtinë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues – teknik, për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 07.06.2017, ka konstatuar se AK-ja, i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë janë të paqëndrueshme, për faktin se AK-ja, gjatë vlerësimit të ofertave AK-ja, i ka kërkuar respektuar dispozitat e nenit 61 të LPP-së, dhe njëherit ka sqaruar se edhe sipas tabelës së rregullores për çmime Jo-Normalisht të ulëta oferta e OE ankues “Office Printy”, konsiderohet si ofertë me çmim Jo-Normalisht të ulët. Prandaj, i ka propozuar panelit shqyrtues që ta refuzoj ankesën e OE ankues si të pa bazuar dhe njëherit i ka propozuar panelit shqyrtues që ta aprovoj vendimin e AK-së, për dhënie të kontratës.

OE ankues "Office Printy" - Prishtinë, edhe pse ka qenë i njoftuar me raportin e ekspertizës nuk e ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet apo jo me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

AK-ja, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendosi që konform nenit 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-se, të mbaj seance pa prezencën e palëve për faktin se palët pas pranimit të raportit nuk kanë ofruar prova të reja lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 09.06.2017, në të cilën ishte prezent kryetari i Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues i cili deklaroi: se qëndroj prapa raportit të ekspertizës se datës: 07.06.2017.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikës pretenduese të parashtresës të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se AK-ja në harmoni me nenin 59 të LPP-së, ka bërë Vlerësimin, Ekzaminimin dhe Krahësimin e ofertave, dhe njëherit paneli shqyrtues, duke u bazuar edhe në sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues në raportin e tij të datës: 07.06.2017, konstaton dhe vlerëson se sipas tabelës së Rregullores për çmime Jo-Normalisht të ulëta të datës: 07.07.2016 të publikuar në ueb faqen e Krpp-së, oferta e OE ankues konsiderohet si ofertë me çmim Jo-normalisht të ulët dhe se me të drejtë AK-Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka eliminuar OE ankues. Përveç kësaj paneli shqyrtues konstaton dhe vlerëson se AK - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka përdorur procedurë *inter partes* me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili

konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët, pra AK-ja, i ka respektuar ne tërësi procedurat e nenit 61 të LPP-së, duke i kërkuar sqarime në lidhje me ofertën e OE ankues.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Goran Milenkovic

